

**PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE  
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje automjet SUV në përdorim të institucionit të Bashkisë Patos”.**

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

**KODI CPV Automjete me Kod 34100000-8**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 1.916.000 (një milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH** vënë në dispozicion nga Të ardhurat lokale 2022.

Kjo procedurë zhvillohet në perputhje me pikën b të nenit 58 dhe nenin 67 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” ku Bashkia Patos është organi të cilit i është deleguar e drejta e kryerjes së procedurës të prokurimit nga për shkak të kapaciteteve që ky i fundit ka në fushën e objektit të prokurimit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Patos** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**Argumentimi:** Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2019, 2020, 2021, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **766.400 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind) lekë.**

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

**1.916.000 x 40% = 766.400 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind) lekë.**

lekë.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrisë të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2022.

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anetar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).*

*Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi fitues përpara dhënies së kontratës.*

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit

publik” dhe ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore per vitin 2020 sipas kësteve prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e

aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

### **2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:**

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**Argumentimi:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

---

**1.916.000 x 20% = 383,200 (treqind e tetëdhjetë e tre mijë e dyqind) Lekë.**

---

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.*

2.3.2. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesin një vetëdeklarim nëpërmjet të cilës marrin përsipër që "Garancia për eliminimin, pa shpërblim, të defekteve të mundshme do të jetë 1 (një) vit nga data e marrjes së mjetit në dorëzim, (përjashtohen rastet kur vërtetohet se defekti është shkaktuar nga pakujdesia e shoferit ose keqpërdorimi i mjetit)".

**ARGUMENTIM:** Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe të pikës 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave. Gjithashtu ky vetdeklarim kërkohet për ti vërtetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të mallit objekt prokurimi.

**ARGUMENTIM:** Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 6 të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Ky vetdeklarim kërkohet per ti vertetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi. Nuk është kërkuar qe OE të kenë detyrimisht një mjet transporti ose të lidhin kontrata qeraje për mjetet por mund ta zgjidhin në cfarëdolloj mënyre alternative për realizimin e kontratës.

2.3.3. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të vetdeklarojnë se nëse shpallen fitues do të mbulojnë të gjitha shpenzimet për kalimin e pronësisë së mjetit në emër të Bashkisë Patos.

**ARGUMENTIM:** Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe të pikës 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe kalimin e pronësisë pa patur kosto shtesë për AK-në pasi ky i fundit nuk ka parashikuar kosto të tjera.

2.3.4. Për mjetin duhet të paraqiten fotografi të qarta dhe origjinale.

**ARGUMENTIM:** Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe të pikës 6/b të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave. Gjithashtu ky vetdeklarim kërkohet për ti vërtetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.5. Operatorët Ekonomik pjesëmarrës duhet të vetdeklarojnë vendndodhjen e mjetit (adresën e saktë) si dhe të dhënat përkatëse të mjetit me qëllim që Autoriteti Kontraktor Bashkia Patos të bëjë verifikimin fizik të gjendjes teknike dhe vizuale të mjetit përpara shpalljes së ofertës fituese për operatorët ekonomik të kualifikuar sipas

renditjes. Përben kusht për skualifikim nëse nga verifikimi vërehet se kemi mospërputhje të Mjetit me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

**ARGUMENTIM:** Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave. Gjithashtu ky vetdeklarim kërkohet për ti vërtetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.6. Njëkohësisht operatorët ekonomik pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi për mjetin që do të ofertojnë duhet të paraqesin dhe të ngarkojnë në sistemin e prokurimit skeden teknike me të dhënat përkatëse të Automjetit shoqëruar me dokumentacionin përkatës të mjetit si, Foto, Siguracion, Certifikatë pronësie, Certifikatën e Kontrollit teknik të mjetit dhe librin e historikut të shërbimeve të përkthyer në gjuhën shqipe nëse libri original është në gjuhë të huaj të vitit të fundit aktual.

**ARGUMENTIM:** Në bazë, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe të pikës 6/c dhe pika 8 të nenit 40 VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, për të garantuar përmbushjen me sukses të kontratës nga OE dhe dhënia e sigurisë AK-së që kontrata do të realizohet sipas kërkesave. Gjithashtu ky vetdeklarim kërkohet për ti vërtetuar dhe garantuar AK-së produkte funksionale dhe realizimin me sukses të kontratës përse i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

## **II. Argumentimi i specifikimeve teknike**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.***

### **Specifikimet për mjetin**

**Viti i prodhimit:** Nuk do të pranohet asnjë mjet i cili është prodhuar para vitit < 2010.

**Kilometrat e kryera:** Mjeti duhet të ketë më pak se 225.000 (*dyqind e njezet e pese mije*) kilometra të kryera (origjinale) dhe nuk do të pranohet asnjë mjet i cili ka më shumë se 225.000 kilometra (*dyqind e njezet e pese mije*). (Mjeti do të nënshtrohet kontrollit të vecantë nëse kilometrat janë manipuluar).

**Dokumentacioni i kërkuar:** Mjeti të jetë i pajisur me:

- Certifikatë Pronësie me
- Targa Shqiptare,
- Siguracion të vlefshëm
- Të ketë kryer kontrollin teknik me cilësinë “kalon”.

### **Cilësitë e kërkuara të mjetit**

**Tempomat:** Limitator shpejtesie

**Pasqyrat:** Pasqyra me palosje antiverbuese me xham me ngrohje.

**Bagazhi:** Hapje bagazhi me pult dhe me buton nga brenda.

**Xhamat e pasëm:** Xhamat e zinj mbrapa të jenë të pajisur me leje të posacme, të miratuar konform të gjitha rregullave për të udhëtuar në Shqipëri dhe jashtë saj.

**Xhami i përparmë:** Xhami parë me nuance antiverbuese.

**Timon:** Multifunksional dhe të jetë i veshur me lëkurë.

**Klimatizator** digital Bizonale para mbrapa.

### **Pajisje me sensor:**

1. Sensor shiu;
2. Sensor drite;
3. Sensor Gomash;
4. Sistem Hold Start;
5. Sensor parkimi para, mbrapa Original Fabrike.

**Air Bag:** Mjeti duhet të ketë minimalisht 10 (dhjetë) airbag, nga 1 (një) air bag për secilin nga trarët tek dyert përpara, 1(një) Air bag në timon tek shoferi dhe 1 (një) air bag tek pasagjeri në kroskot, Air bag tek anët e të dyja sendileve shoferi dhe pasagjeri, Air bag tek trari i sipërm në të majtë të shoferit dhe air bag mbi trarin e sipërm nga ana e djathtë e pasagjerit.

**Shërbimet periodike:** Vaj, filtra dhe cdo shërbim i kryer të jenë bërë në kompani të licensuara dhe të jenë dokumentuar në librin e shërbimeve të mjetit.

**Ngjyra:** Nuk ka përcaktim por preferohen ngjyrat e errëta.

**Çelsat:** Mjeti duhet të jetë i pajisur me 2 (dy) Çelsa orgjinale (mjeti nuk do të pranohet nëse çelsat janë të duplikuar ose të koduar në Shqipëri ose në ndonjë shtet tjetër pervec distributorit të licensuar nga kompania orgjinale që ka prodhuar mjetin.

**Sistem GPS:** Mjeti duhet të jetë i pajisur me sistem e pozicionimit global (Global Positioning System - GPS), i cili duhet të tregoj saktësisht dhe në kohë reale se ku ndodhet mjeti, distancën e përshkruar dhe të jetë i gjurmueshëm në cdo orë 24/7.

**Segmentimi i EEC:** J (D) (makina sportive dhe automjete jashtë rrugës - segmenti D - i madh)

**Nënsegmenti:** J-D-4WD (mjete e madhe sportive me katër rrota dhe automjete të mëdha jashtë rrugës)

**Klasa:** Kompakte jashtë rrugës / SUV (automjet sportiv i shërbimeve)

**Stili i trupit:** Vagon sportiv

**Dyert:** 5

**Lloji i karburantit:** Diesel (Naftë)

**Motori:** Mjeti duhet të jetë i pajisur me një motor me 4 (katër cilindra) në linjë me 4 valvula për cdo cilindër, pajisur me Turbo + Intercooler.

**Madhësia e motorit:** Motori duhet të jetë midis intervalit, 2000cc <--- ---> 2200cc.

**Konsumi:** Mjeti nuk duhet të kaloj konsumin 7.5 litra karburant për 100km e kombinuar.

**BHP Kuaj Fuqi:** Mjeti duhet të ketë kuaj fuqi midis intervalit 140 – 160 kuaj fuqi.

**Shpejtësia maksime (Top Speed):** Maksimumi i shpejtësië duhet të jetë deri në 190 km/h.

**Tërheqja (Traction):** 4x4 sipas kërkesës (e pasme angazhohet automatikisht kur zbulohet rrëshqitje e rrotave të përparme, sistemi Haldex i gjeneratës së 4-të me tufë me shumë pllaka të operuara në mënyrë hidraulike)

**Ndotja e gazrave:** Nuk do të pranohet asnjë mjet që ndotjen nga emisionet e gazit e ka më pak se Euro 4.

**Gomat dhe disqet:** Mjeti duhet të jetë i pajisur me dy sete gomash 100% të reja (1 set ka 5 goma), 1(një) set duhet të jetë për goma vere dhe 1(një) set duhet të jetë goma dimri. Gomat duhet të jenë të markës ose ekuivalent i (Pirelli, Michelin, Continental, Bridgestone etj..). Disqet duhet të jenë aliazh alumini.

**Origjina e mjetit përta i përket përdorimit në rrugë:** Mjeti duhet të jetë prodhuar specifikisht për përdorim në Europë. Ky kriter kërkohet sepse performanca e mjetit është konform rregullores së Federatës Ndërkombëtare të Automobilave (Federation Internationale de l'Automobile, FIA) për mjetet që qarkullojnë në Kontinentin Europian.

**Historia e aksidenteve:** Mjeti duhet të jetë “accident free” pra nuk duhet të ketë një histori aksidenti, për këtë kriter mjeti do të ushtrohet një kontrolli të vecantë nga një komision i ngritur pranë Bashkisë Patos.

**Shasia:** Mjeti nuk duhet të ketë ndryshk, zevëndësime apo prerje të trupit të cilat mund të jetë salduar apo modifikuar për tu sjellë në gjendjen e mëparëshme.

**Pamja vizuale:** Mjeti nuk duhet të ketë gërvishtje, shtypje ose deformime.

**Sistemi operativ softwerik:** Sistemi operativ i mjetit duhet të jetë 100% funksional, nuk duhet të ketë ndërhyrje softwerike ose kodime softwerike nga persona ose oficina jo të autorizuar nga prodhuesi i mjetit si në sistemin qëndror ashtu dhe në paketa të vecanta si kambio, transmission ose sistemin e drejtimit. (Për këtë mjeti do të nënshtrohet një kontrolli të imtësishëm me pajisje të vecanta për të treguar në cdo ndërhyrje softwerike që mund të jetë bërë mjetit).

**Pjesët gjenerike dhe mekanike:** Të gjitha pjesët gjenerike dhe mekanike duhet të jenë minimalish të reja në masën 95%.

**Pajisjet digitale:** Pajisjet digitale si paketa, dhe sistemet elektronike duhet të jenë 100% funksionale, nuk do të pranohet asnjë mjet i cili ka paketa të ndërruara, jo origjinale ose të përdorura dhe të koduara nga persona apo oficina jo të licensuara nga kompania prodhuese e mjetit.

### Suspensioni, Drejtimi dhe Frenimi

Suspensioni i përparmë	I pavarur me susta me spirale
Suspensioni i pasëm	I pavarur me susta me spirale
Lloji i amortizatorëve	Mbështjellje me spirale
Kolona drejtuese	Anim
Lloji i pajisjes drejtuese	Raft & Pinion
Rrezja e kthesës (metra)	5.7 metra
Lloji i frenave të përparme	Disk
Lloji i frenave të pasme	Disk

### Komforti dhe komoditeti

Drejtues me energji elektrike	
Xhama elektrike të përparëm	
Xhama elektrik të pasëm	
Kondicioner	
Ngrohës	
Drejtues i rregullueshëm	
Kontrolli automatik i klimës	
Kontrolli i cilësisë së ajrit	



Hapësi i trungut në distancë	
Hapësi i kapakut të karburantit në distancë	
Drita paralajmëruese për karburant të ulët	
Prizë shtesë e energjisë	
Drita e trungut	
Pasqyrë Vanity	
Llamba e pasme e leximit	
Mbështetësja e kokës e sediljes së pasme	
Mbështetëse krahu qendrore e sediljeve të pasme	
Rripat e sigurimit të përparmë të rregullueshëm në lartësi	
Mbajtësit e Kupës-Përpara	
Mbajtësit e Kupës-Prapa	
Ventilimet e pasme të AC	
Mbështetje mesit e sediljes	
Kontrolli i vozitjet	Tempomat
Sensorë parkimi	Para dhe Pas
Sedilja e pasme e palosshme	60:40 Split
Hyrja e kartës së hyrjes inteligjente	
Hyrja pa çelës	
Butoni i nisjes/ndalimit të motorit	

### Interiori

Tahometri	
Multi-Tripmetër Elektronik	
Sedilje lëkure	
Kroskot	
Ore digjitale	
Ekrani i temperaturës së jashtme	
Ndëzës i cigares	
Odometri dixhital	
Sedilje të rregullueshme elektrike	Përpara
Sedilja e shoferit e rregullueshme në lartësi	

### Exteriori

Fenerët e rregullueshëm	
Dritat e mjegullës - Përpara	
Dritat e mjegullës - Pas	
Pasqyrë e jashtme e rregullueshme me energji të pasme	
Pasqyrë elektrike e palosshme e pamjes së pasme	

Fshirës me sensor shiu	
Fshirës i dritares së pasme	
Larës i dritareve të pasme	
Shkarkues i dritares së pasme	
Mbulesa për rrota	
Rrota aliazh alumini	
Antenë e energjisë	
Lloji i gomave	Tubeless,Radial

## Siguria

Sistemi i frenimit kundër bllokimit	
Ndihma e frenimit	
Mbyllje qendrore	
Brava me energji elektrike	
Brava për sigurinë e fëmijëve	
Alarmi kundër vjedhjes	
Airbag shoferi	
Airbag i pasagjerit	
Airbag anësor-Përpara	
Airbag anësor-Prapa	
Pasqyra e pamjes së pasme të ditës dhe të natës	
Pasqyra anësore e pasagjerit	
Fenerët ksenon	
Rripat e sigurimit të pasmë	
Paralajmërim për rripin e sigurimit	
Paralajmërim i hapur i derës	
Trarët me ndikim anësor	
Trarët me ndikim të përparmë	
Kontrolli i tërheqjes	
Sedilje të rregullueshme	
Monitor i presionit të gomave	
Sistemi i Kontrollit të Stabilitetit të Automjeteve	
Imobilizues i motorit	
Sensori i përplasjes	
Rezervuari i karburantit i montuar në qendër	
Paralajmërim për kontrollin e motorit	
Fenerët automatikë	
EBD	

Pajisje kundër vjedhjes	
-------------------------	--

### **Argëtim & Komunikim**

Cd Player	
DVD Player	
Radio	
Telekomanda e sistemit audio në Timon	
Altosparlantët e përparmë	
Altosparlantët e pasëm	
Audio 2DIN e integruar	
Hyrja USB dhe ndihmëse	
Lidhshmëria me Bluetooth	

Specifikimet teknike të Hartuara janë bazuar në nevojat e Autoritetit Kontraktor bazuar në pikën 2 neni 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar për të patur një Automjet cilësor e të përshtatshëm për funksionalitetin e veprimtarive që zhvillohen.

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **05/01/2023, ora 11:00**.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje bazë materiale grumbullimin e mbetjeve urbane:.

### **Bashkëlidhur këtij procesverbali:**

Dokumentat e tenderit.

### **NJESIA E PROKURIMIT**

Daniela **Kukaj**

Arben **Manoku**

Florian **Kita**